



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

### **Nr. 50**

Datë: 11. 08. 2021. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Zuviq, Fazli Stollaj.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misni; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

#### **1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së Nr.49/2021.

#### **2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**

#### **3. Aktivitetet e ZRPPC-së:**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për certifikim të subjekteve politike.

#### **4. Këshillat e KQZ-së:**

**Këshilli për Çështje Ligjore:**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Gjakovë,

Shqyrtimi i njoftimit për votuesit jashtë Kosovës që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës.

#### **5. Komiteti i Auditimit të Brendshëm të KQZ-së:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Statutit të Komitetit të Auditimit,
- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës të Komitetit të Auditimit.

#### **6. Të ndryshme !**

---

#### **1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**Kreshnik Radoniqi:** Po e hapim mbledhjen, nuk do t'i kemi mediat sepse nuk ka shkuar imelli. Mbasi që kryesusi rezymoi agjendën e mbledhjes, ai i pyeti anëtarët e KQZ-së nëse do t'i votojnë sot përbërjet e këshillave të KQZ-së apo, mbasi që KOZ ka nesër trajtim të agjendës me përbërje të vjetër, ndoshta është mirë që kjo çështje të shtyhet dhe ti mundësohet KOZ-it aktiviteti me përbërjen e deritanishme. A pajtoheni ? Në këtë pikë, diskutuan: Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi. Mbas këtyre diskutimeve anëtarët e KQZ-së miratuan rendin e ditës.

Në vazhdim, u shqyrtua procesverbali nr. 49 të KQZ-së, me interesimin e z. Kurteshi rreth incizimit të mbledhjes nga aspekti teknik, dhe të mos prezencës së mediave në mbledhje.

( Regjistrimi nga pika e tretë e mbledhjes, fillon teknikisht në këtë pikë, pra ka pasur lëshime teknike ( F.A – procesmbajtës). Ndërsa, rreh mos pranisë së mediave, u tha se dy imella njëri pas tjetrit lidhur me mbajtjen e mbledhjes, ka shkaktuar konfuzion ( V.E – zëdhënës).

**Alim Rama:** Ne, është problem me mbajte mbledhje pa mjetet e informimit, sidomos kur është në pyetje cerifikimi i subjekteve politike...!

**Yll Buleshkaj (ZRPP):** Pika tre, mund të shtyhet për nesër, jemi brenda afatit dhe nuk është problem...

**Florian Dushi:** Në Shqipëri për shembull, KQZ i mban mbledhjet duke i transmetuar drejtpërdrejtë...

**Alim Rama:** Kjo kërkesë, është bërë qysh vjet, nuk kushton shtrenjtë por mungon vullneti...

**Kreshnik Radoniqi:** E bëjmë, së paku deri sa jam unë këtu nuk ka pasur kërkesë...

Në fund, procesverbali u miratua me një votë abstenim (Sami Kurteshi).

## **2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së**

**Burim Ahmetaj:** **Të ndëruar anëtarë të KQZ-së,** periodha e shërbimit të votuesve për ndërrimin e Qendrave të Votimit ka filluar me datën 20 korrik 2021. Nga kjo datë, e deri më 10 gusht 2021, në orën 15:00, përmes platformës online për ndërrimin e qendrës së votimit, janë parashtruar rreth 1,700 kërkesa për ndërrim të qendrave të votimit. Po nga data 20 korrik 2021, deri me datën 6 gusht 2021, në Zyrat e KKZ-ve, janë parashtruar 200 kërkesa për ndërrimin e qendrave të votimit përmes formularëve të aplikimit. Në total i bie se, deri më tani janë parashtruar rreth 1,900 kërkesa për ndërrim të qendrave të votimit.

Përmes këtij raporti, ju njoftojmë se rezultatet e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, prej datës kur ka filluar (10 korrik 2021) dhe deri me datën 10 gusht 2021, në orën 15:00, përfshijnë aplikimin e gjithsej: 3,547 aplikacione për regjistrim. Të gjitha aplikacionet janë pranuar përmes emailit. Nga këto 3,547 aplikacione, 3,301 aplikacione janë aprovuar, që do të thotë se aplikuesit kanë plotësuar kriteret juridike për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Të ndëruar anëtarë, ne u kemi dërguar njoftim aplikuesve se kërkesat e tyre janë aprovuar me shpjegimet e nevojshme mbi procesin. Kurse, 245 aplikacione për regjistrim nuk janë aprovuar (në pritje), për shkak se aplikuesit nuk kanë plotësuar kriteret juridike për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës. Për këtë, shërbim votues u ka dërguar email atyre aplikuesve që nuk i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara, dhe iu ka dërguar njoftimet specifike për dokumentet që duhet t'i dërgojnë në mënyrë që, të ju aprovohen kërkesat për regjistrim si votues jashtë Kosovës. Ndërsa, një aplikacion është refuzuar, për shkak që aplikuesi është nën moshën 18 vjeç.

Ahmetaj tha se, në kuadër të aktiviteteve të planit të punës së KQZ-së për vitin 2021, është edhe aktiviteti që ka për qëllim vizitat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nëpër zyrat e KKZ-ve në secilën komunë. Janë realizuar vizitat në KKZ-të e regjionit të Gjilanit ( Gjilan, Viti, Kamenicë, Novobërd, Ranillug, Kllokot dhe Partesh ). Pastaj, janë realizuar vizitat në Mitrovicën e Jugut, Vushtrri, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok.

Sekretariati në përputhje me planin e rekrutimit, ka përmbyllur fazën e dytë të rekrutimit të stafit jo permanent, që do të angazhohen në zgjedhjet lokale, që do të mbahen me 17 tetor 2021. Kandidatët që kanë konkurruar, në të gjitha pozitat e shpallura, i janë nënshtruar vlerësimit nga Komisionet e vlerësimit, duke respektuar parimin në bazë të meritës dhe po ashtu është marrë në konsideratë edhe përvoja në zgjedhje. Sekretariati është duke u përgatitur për të zhvilluar fazën e tretë të procesit të rekrutimit të stafit jo permanent, bazuar në planin e rekrutimit për të ndihmuar në kryerjen e aktiviteteve dhe në përkrahje të procesit për organizimin e zgjedhjeve.

Në përfundim të raportit mbi aktivitetet e SKQZ-së, Sami Kurteshi kujtoi se në mbledhjet e kaluara ka shtruar pyetje lidhur me ARC-në. A është rifreskuar lista – ekstrakti ? A është dërguar edhe një letër që ka qenë dashur ti dërgohet ARC-së. Ilir Gashi, pyeti rreth faktit se ka persona që kanë dokumente valide të Republikës së Kosovës, mirëpo nuk gjendet në listën votuese, dhe më konkretisht në Mitrovicë, personi gjendet në listë në jug, kurse vendvotimin e ka në veri... ! Ky është një shqetësim...! Edhe një pyetje: një takim ish dashur ta kemi me kryetarin e Asocianit të Komunave që të mbështeten KKZ-të, pra nuk jemi vetëm ne faktor zgjedhor, sepse ka edhe faktorë të tjerë relevant...prandaj, një takim me asociacionin kishte me qenë impuls për komunat që ta mbështesin procesin zgjedhor...

**Arianit Elshani**, tha se e mbështesë idenë për një takim të këtillë, ndërsa që ai foli rreth vizitave në KKZ në komunat veriore dhe, foli për gjendjen në këto KKZ...

**Alim Rama**: Shihet disprepanca e kushteve të KKZ-vë në disa komuna, me disa komuna të tjera. Ai, përmendi me shembuj komunat me gjendje të vështirë... Ne, mandej duhet të kujtojmë që jo vetëm duhet ti mbështesim, por ligji për zgjedhjet i obligon komunat që ti mbështesin KKZ-të...

**Florian Dushi**, po këto ekipe të KQZ ka qenë mirë ti takojnë edhe kryetarët e komunave, mirëpo duke qenë se shumica e tyre janë kandidat në zgjedhje, u kemi ikur takimeve...Megjithatë, mendoj që ne duhet të vendosim linja komunikimi për ti ndihmuar zyrtarët tanë...forma ma e mirë, do ishte që Koordinimi në Terren, t'i përgatisë draft – kërkesat e secilës KKZ-së dhe ato të adresohen në institucione të caktuara...

**Burim Ahmetaj**, foli rreth gjendjes së KKZ-vë, mungesës së objekteve, çështjeve teknike të rrymës si në Skenderaj, kurse me ARC-në tha se janë takuar dhe janë diskutuar çështjet të rëndësishme rreth dokumenteve të skaduar, ekstraktit civil etj. Pra, kemi bashkëpunim dhe takime të tjera... E kemi dërguar edhe letrën...

Kreshnik Radoniqi: Me krye shefin, kemi diskutuar rreth problemeve që kanë KKZ-të, dhe kjo pjesë nuk është e neglizhuar nga ana jonë, dhe mendoj që e kemi parasysh dhe do të ndërmarrim hapa sa u përket përmirësimit të kushteve të KKZ-vë në secilën komunë...

### **3. Aktivitetet e ZRPPC-së:**

#### Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për certifikim të subjekteve politike:

**Yll Buleshkaj:** Tash, për shkak të afatit në përfundim ose afër përfundimit, ne do të ju mbajmë të informuar me raporte ditore për rrjedhën e certifikimit. Gjithashtu, si zyre po merremi edhe me procesin e auditimit, jemi në komunikim të vazhdueshëm dhe javën e kaluar, e kemi organizuar një takim me përfaqësuesit apo zyrtarët financiarë të partive politike në frymën e iniciativës ku është trajtuar si ide në këshillin për çështje ligjore për transferimin edhe të pjesës së fundit të mjeteve prej 10% te partitë politike, pra menaxhimin e fondeve...

Jemi në proces të certifikimit, kemi më shumë kërkesa për certifikim. Do të punojmë edhe të shtunën dhe të dielën, pra do të jemi vazhdimisht në zyre. Kjo, për të tërhequr vëmendjen e partive në mënyrë që të mos kemi ditën e fundit grumbullim, por kjo varet prej partive se a do të vijë për certifikim, a e kanë dokumentacionin gati...

Një rast që e kemi pasur, partia që për shkak të emrit e tërhoqëm po besoj që e ka ndryshuar dhe e ka një emër të pranueshëm...

Në proces të certifikimit po hasim probleme, disa kandidatë që kanë ndryshuar vendbanimin, e kanë bërë ndryshimin e adresave, por nuk po arrijnë ti marrin letërnjoftimin, nuk po arrijnë të jenë në sistem...Kemi diskutuar me ARC-në, dhe kemi arritur në përfundim që ata persona që duan të barten, ani pse nuk ju ka realizuar letërnjoftimit, të barten në listë ku ata janë transferuan apo, duan të kandidojnë në komunën përkatëse... Pra, nëse janë plotësuar kushtet ligjore, pavarësisht mungesës së letërnjoftimit të barten në listën e caktuar votuese në komuna, që janë njësi të veçanta votuese...

Problemi më i komplikuar është me ata që kanë pasur dokumente të UNMIK-ut, ndërsa me vendim të KQZ janë larguar nga lista votuese. Por, në ndërkohë kanë aplikuar për letërnjoftim por letërnjoftimet nuk janë prodhuar. Ne, nuk mund ti fusim në listë, sepse njëherë i kemi larguar...Zgjidhja, është që ne ta dërgojmë listën, dhe nga fondi emergjent të sigurohen dokumentet...

Rreth kësaj pike, Arianit Elshani kërkoi intensifikimin e komunikimit dhe bashkëpunimit me ARC-në, ndërsa pyeti rreth planit 2021 rreth një serveri për financimin e partive – raportimet financiare..

Alim Rama, tha se ekstrakti është bazë, por në mungesë të dokumenteve – kërkesave, ne duhet ti aprovojmë këto kërkesa...Pra, ne mos t'ia kufizojmë askujt mundësinë, pavarësisht problemeve teknike...

Yll Buleshkaj, tha se ne e kemi këtë projekt të serverit, por nuk është në shpenzimet kapitale dhe përkundër kërkesave, ende s'kemi një donacion ndonëse, po përpiqemi ta sigurojmë...E kemi një koncept për këtë... Te lista votuese, KQZ nuk ka mundësi t'ia ndërroj komunën votuesit, por ka mundësi t'ia ndërroj vendvotimin...

Në këtë pikë, diskutuan edhe Florian Dushi, tha se nuk guxon që të privohet asnjë kandidat, pavarësisht se ku ai dëshiron me votue...Pra, komunikimi duhet të zhvillohet, madje edhe mbas certifikimit, deri në përmbylljen finale...

Në këtë pikë diskutuan edhe: Ibrahim Selmanaj, Ilir Gashi, i cili theksoi se çështja nuk është aq e lehtë dhe se lypse nga ne një interpretim ligjorë sepse, kjo duhet të sigurohet me kohë....

Burim Ahmetaj, tha se janë dy procese të ndara: certifikimi i kandidatëve që duan të kandidohen, dhe votuesit që dëshirojnë ta ndërrojnë komunën. ARC, na dha mundësi: ata kanë detabazën, dhe aplikimet e qytetarëve janë vanide, dhe mund të futen në ekstrakt, ende pa iu prodhuar dokumenti...Pra, mund të aprovet kërkesa që të jenë në listën votuese duke u alokuar në komunën përkatëse... Mund të ketë problem vetëm për ata të rinjë që s'kanë pasur asnjëherë dokumente, dhe ata që kanë pasur dokumente të UNMIK-ut, por po bashkëpunojmë të gjejmë zgjidhje edhe në këtë drejtim...

#### **4. Këshillat e KQZ-së**

##### **Këshilli për Çështje Ligjore**

###### **1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Gjakovë:**

**Arianit Elshani:** Këshilli ka shqyrtuar kërkesën për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Gjakovë, dhe pas shqyrtimit këshilli ka rekomanduar që të aprovet, meqë ka plotësuar gjithë kriteret ligjore dhe në raport me aktgjykimin e gjykatës kushtetuese për përfaqësimin gjinor në kuvend...

**Kreshnik Radoniqi:** Në bazë të rekomandimeve të këshillit, znj. Adelina Rexhepi emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Gjakovë nga subjekti politik “Aleanca për Ardhmërinë Kosovës – AAK”, duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj. Florentina Gjergjaj.

Miratohet ky rekomandim me vota unanime.

## 2. Shqyrtimi i njoftimit për votuesit jashtë Kosovës që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës:

**Florian Dushi:** Është një çështje që është ngritë në këshill, por edhe në KQZ. Ka të bëjë me një kategori shoqërore që disponojnë me dokumente valide, por ndërkohë kanë bërë kërkesa, dhe kërkesat e tyre janë aprovuar nga organet kompetente dhe kanë hequr dorë nga shtetësia e Kosovës! Si do të sillet KQZ, dhe si do të trajtohet kjo çështje... ?

Në këshill, kemi pasur tri opzione por, unanimitisht është vendosur sipas këtij opcioni, që: ***“Aplikuesit që kanë aplikuar me dokumente të vlefshme të lëshuara nga Republika e Kosovës, por që kanë hequr dorë nga shtetësia, të refuzohen dhe të njoftohen për arsyen e refuzimit!”***

Këshilli, është bazuar dhe mbështetur mbi kriteret kushtetuese.

**Fazli Stollaj:** Kjo që u rekomandua, a nënkupton që lista e votuesve jashtë Kosovës, duhet të kontrollohet...A është vështirë ?

**Burim Ahmetaj:** Secili aplikant, krahasohet me listën përfundimtare të votuesve...

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për...?

*Rreth korigjimit të tekstit, dhanë vërejtje Alim Rama dhe Arianit Elshani. Rama tha se duhet vendimi duhet të jetë “për të gjithë” dhe jo të ceket në vendim “votuesit jashtë Kosovës” por, të gjithë ata qytetarë që kanë hequr dorë nga shtetësia e Kosovës...*

Në fund, ky rekomandim u miratuan në mënyrë unanime.

## 5. Komiteti i Auditimit të Brendshëm të KQZ-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i Statutit të Komitetit të Auditimit:

**Sami Kurteshi:** Ju, keni pranuar dy dokumente mirëpo, për shkak të kohës nuk janë nxjerrë për miratim. Tani, e keni Statutin dhe Planin e Punës të Komitetit të Auditimit për vitin 2021. Janë shqyrtuar relativisht gjatë, analizuar, janë mbështetur në ligje, rregullore dhe janë korrigjuar gjuhësisht, janë korrigjuar...

Kështu që, ne rekomandojmë për miratim .

**Alim Rama:** Të shpjegohen shkurtesat në statut ( në fillim të tekstit, ose me fusnotë... ) ?

**Sami Kurteshi:** Po, është shumë e drejtë...

**Florian Dushi:** A duhet dhe, a është bërë shqyrtimi i këtyre dy dokumenteve brenda vetë Komitetit...

**Sami Kurteshi:** Po, pa diskutim: fjali për fjali... Dhe, dy dokumentet e kanë mbështetjen e komitetit.

**Ilir Gashi:** Pra, na garantoni se ky statut është në harmoni të plotë: roli dhe përgjegjësitë e komitetit janë në kuadër dhe kompetenca kushtetuese – ligjore si anëtarë të KQZ...

**Sami Kurteshi:** Po, janë përdorur ligjet, udhëzimet administrative për funksionimit të komitetit të auditimit, dhe se Auditori i përgjigjet vetëm kryetarit të KQZ. Pra, komiteti e ka një rol: me qenë i pavarur, dhe neutral...E siguron, edhe pavarësinë e auditorit...

**Kreshnik Radoniqi:** Pra, sa kuptova, komiteti nuk i tejkalon kompetencat e veta...

**Sami Kurteshi:** Komiteti, është kompetent sepse, janë tre anëtarë të jashtëm janë profesional dhe kompetent...

**Ilir Gashi:** Është trupë specifike...Pra, ne të jemi të bindur: që çdo gjë të jetë në relacion me rolin dhe përgjegjësitë tona...

**Ibrahmi Selmanaj:** Gjithçka është bazuar mbi bazë të ligjit dhe përvojën. Është debatuar gjatë, është elaboruar mjaftueshëm dhe mendoj që duhet aprovuar...

Në këtë pikë, diskutuan edhe më tutje: Florian Dushi, Alim Rama, Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Fazli Stollaj.

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për ?

Me vërejtjet e dhëna, sidomos mbi shkurtesat në tkest, statuti miratohet unanimisht.

**Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës të Komitetit të Auditimit:**



**Kreshnik Radoniqi:** A doni ta diskutojmë planin e punës së Komitetit të Auditimit, apo e hedhin ë votim...?

Nëse jo, kush është për ?

Miratohet me vota unanime edhe Plani i Punës së Komitetit të Auditimit për vitin 2021.

## **6. Shqyrtimi dhe miratimi i rishikimit të Këshillave të KQZ-së.**

**Kreshnik Radoniqi:** Jemi marrë vesh për këshillat në takimin e paradites. Ne, do ti votojmë një nga një...

Për secilin këshill, nuk kemi pasur konsensus.

Unë, po i paraqesë:

### **I. Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë**

1. *Kreshnik Radoniqi – kryesues*
2. *Rifat Krasniq – zëvendëskryesues*
3. *Fazli Stollaj – anëtarë*
4. *Ilir Gashi – anëtarë*
5. *Sami Kurteshi – anëtarë.*

**Miratohet me dy vota kundër ( Alim Rama dhe Sami Kurteshi).**

### **II. Këshilli për Personel**

1. *Alim Rama – kryesues*
2. *Ibrahim Selmanaj – zëvendëskryesues*
3. *Arianit Elshani – anëtarë*
4. *Gordana Zuvij – anëtar*
5. *Qemajl Kurtishi – anëtarë*

**Miratohet me 1 votë abstenim (Alim Rama )**

### **III. Këshilli për Buxhet dhe Financa**

1. *Gordana Zuvij – kryesuese*

2. *Ilir Gashi – zëvdnëskryesues*
3. *Florian Dushi – anëtarë,*
4. *Alim Rama – anëtarë*
5. *Fazli Stollaj – anëtarë*

**Miratohet me vota unanime**

#### **IV. Këshilli për Cështje Ligjore**

1. *Florian Dushi – kryesues*
2. *Sami Kurteshi – zëvendëskryesues*
3. *Ilir Gashi – anëtarë*
4. *Ibrahim Selmanaj – anëtarë*
5. *Qemajl Kurtishi – anëtarë*

**Miratohet me një votë kundër (Alim rama)**

#### **V. Këshilli për Operacione Zgjedhore**

1. *Arianit Elshani – kryesues*
2. *Alim Rama – zëvdnëskryesues*
3. *Florian Dushi – anëtarë*
4. *Rifat Krasniq – anëtarë*
5. *Fazli Stollaj – anëtarë*

**Miratohet me dy vota kundër (Alim Rama dhe Sami Kurteshi ), dhe më një votë abstenim ( Arianit Elshani ).**

Në fund, Alim Rama shpjegoi se pse ka votuar kundër duke theksuar se, “këto këshilla janë votuar me arrogancë të votave, nuk përfaqësojnë as profesionalitetin dhe përvojën dhe se këto këshilla, kanë me shkaktuar probleme...”.

**Kreshik Radoniqi:** E kemi edhe shqyrtimin e këshillit që ndërlidhet me Informimin Publik! Anëtari i këshillit Rifat Krasniqi, zëvendësohet me anëtarin Florian Dushi në Këshillim Mbikëqyrës të Informimit Publik për Zgjedhjet Lokale 2021.

Miratohet nga anëtarët e KQZ-së.

**Florian Dushi:** Le të konstatohet edhe në procesverbal: çështja e kësaj salle, do të thotë edhe çështja e transmetimit live në këtë sallë të takimeve tona, mirë do ishte të lëvizin...Jemi bërë të ngurtë, sepse kemi thënë që jo vetëm ambienti ynë i punës por edhe metodat e tjera të punës tonë, të jenë më praktike...Sekretariati, duhet me gjet forma që, sa më parë të realizohen kërkesat që i kemi dhënë...

Po ashtu, kryetari Kreshnik Radoniqi, tërhoqi vërejtjen e përdorimit të telefonave në mbledhje...

## **7. Të ndryshme !**